

# buletiniinfo

Buletin informativ mujor  
Tetor, 2022



## KËSHILLI DREJTUES ZGJEDH KRYESINË E RE TË IRDK-së



Përkuftohet Ibish Bajrami



Monitorohet implementimi i projekteve nëpër komuna



Deputeti Fridon Lala takon veprimtarët në diasporë



## KËSHILLI DREJTUES ZGJEDH KRYESINË E RE TË IRDK-së

Këshilli Drejtues i IRDK-së, i kryesuar nga Kryetari i IRDK-së, e ka mbajtur mbledhjen e parë pas zgjedhjeve në Kuvendin e VIII-të zgjedhor. Anëtarët e Këshillit Drejtues janë pajtuar që rendi i ditës së kësaj mbledhje të jetë: Fjala hyrëse e kryetarit të IRDK-së, Zgjedhja e Kryesuesit të Këshillit Drejtues, Zgjedhja e Zëvendëskryetarit të IRDK-së, Zgjedhja e dy Nënkryetarëve të IRDK-së, Zgjedhja e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Sekretarit Organizativ. Zgjedhja e Përgjegjësit Financiar, Zgjedhja e anëtarëve tjerë të Kryesisë dhe të Ndryshme.

Në fjalën hyrëse, kryetari i IRDK-së, ka veçuar ngjarjet kryesore politike gjatë periudhës 1 vjet e gjysmë sa IRDK është në Qeveri. Ai është përqendruar të premtimet e dhëna duke u ndalur te secili premtim dhe duke treguar progresin dhe pengesat e paraqitura. Edhe deputeti Fridon Lala ka mbajtur një fjalë para anëtarëve të Këshillit Drejtues. Edhe deputeti Lala ka veçuar zhvillimet kryesore të komuniteti Egjiptian gjatë kësaj periudhe duke i përmendur progresin që ka ndodhur dhe problemet që na presin për të ardhmen.



Përmes votimit të fshehtë, Kryesues i Këshillit Drejtues është zgjedhur Astrit Shala.

Zëvendëskryetar i IRDK-së është zgjedhur Fridon Lala, ndërsa Nënkryetar të IRDK-së janë zgjedhur Valmir Rama dhe Hysnije Berisha.

Sekretar i Përgjithshëm është zgjedhur Muhamrem Asllani dhe Sekretar organizativ është zgjedhur Mergim Neziraj. Përgjegjës Financiar është zgjedhur Skender Qorri. Koordinatore për Gratë në IRDK është zgjedhur Mirjeta Qehaja, Koordinator për Rini është zgjedhur Jeton Rrahmani dhe Koordinator për Diasporën është zgjedhur Eros Gashi. Zëdhënëse e IRDK-së është zgjedhur Aida Morina.

Kryesia e IRDK-së tani ka këtë përbërje:



Elbert Krasniqi, Kryetar  
Fridon Lala, Zëvendëskryetar  
Valmir Rama, Nënkryetar  
Hysnije Berisha, Nënkryetare  
Astrit Shala, Kryesues i KD  
Muhamrem Asllani, Sekretar i përgjithshëm  
Mergim Neziraj, Sekretar organizativ  
Skender Qorri, Përgjegjës financiar  
Mirjeta Qehaja, Forumi i gruas  
Jeton Rrahmani, Forumi rinos  
Eros Gashi, Koordinator për diasporë  
Aida Morina, Zëdhënëse  
Avdyl Berisha, Anëtar  
Lush Çukaj, Anëtar  
Idriz Murtezi, Anëtar  
Kreshnik Beqiri, Anëtar  
Arjeta Shala, Anëtare  
Sali Berisha, Anëtar  
Gazmend Qyqalla, Anëtar



## PËRKUJTOHET VEPRIMTARI IBISH BAJRAMI

Me datën 22 Tetor 2022, në 11 vjetorin e ndarjes së veprimtarit Ibish Bajrami, Kryetari i IRDK-së Elbert Krasniqi, i shoqëruar nga bashkëpunëtor partiake dhe familjar, kanë bërë homazhe te varri i Ibish Bajramit. Kryetarin Elbert Krasniqi e shoqëruan deputeti i IRDK-së në Parlamentin e Kosovës Fridon Lala, Xhevdet Neziraj, Fazli Stollaj, Skender Qorri, Kumrije Bajrami dhe bashkëpunëtor e familjar të tjerë.

Kryetari Elbert Krasniqi, në këtë rast theksoi se Ibishi, ishte themelues i IRDK-së dhe prijësi i të gjitha iniciativave politike për përmirësimin e gjendjes së komunitetit egjiptian në Kosovë. Ibishi, ishte aktivist politik, pedagog, zv. Ministër, nënkyetar komune dhe mbetet figura më karizmatike e komunitetit egipitan.

Te gjithë ata që patën fatin dhe mundësinë ta njohin dhe te bashkëpunojnë me Ibishin, janë dëshmitarë për qëndrueshmërinë dhe parimet njerëzore të tij. Për ne gjenerata e reja mbetesh frymëzim dhe udhëzim i përjetshëm.

Ibish Bajrami u nda ngajeta me 22 Tetor 2011.



## NDARJEN E FONDEVE NGA ZYRA E KRYEMINISTRIT PËR ÇËSHTJE TË KOMUNITETEVE

Në seancën datës 14 Tetor 2022, deputeti i IRDK-së në Parlamentin e Kosovës, Fridon Lala, ka shprehur shqetësimin në lidhje me ndarjen e fondeve nga Zyra e Kryeministrat për Çështje të Komuniteteve si dhe papranueshmërinë e tij dhe të OJQ-ve dhe mediave të komunitetit Egjiptian për implementimin e projekteve tona nga të tjera.

Me datën 20 Maj 2022, Zyra e Kryeministrat për çështje të komuniteteve, e kishte hapur thirrjen Mbrojtja dhe promovimi i komuniteteve në Kosovë, thirrje kjo që paraqiste përkrahje financiare për OJQ-të dhe mediat që punojnë në kuadër të Drejtave të komuniteteve jo shumicë në Kosovë. Në mënyrë që secili komunitet të përkrahet dhe të përfitoj nga kjo mundësi, thirrja kishte specifikuar ndarjen financiare për secilin komunitet proporcionalisht popullatës së tij. Për komunitetin Egjiptian ishin të ndara gjithsej 44 232,50 euro për të dyja kategoritë. Sidoqoftë, lista përfundimtare e përfituesve nga kjo thirrje e publikuar në shtator, asnje apo 0 organizata apo medie të komunitetit Egjiptian janë përfitues. Ky fakt shqetësues rendohet edhe më tepër kur shohim se implementimi i projekteve për komunitetin Egjiptian i besohet organizatave që nën një nuk janë organizata të komuniteti Egjiptian, nën dy nuk janë organizata me bazë në komunitet por përqendrohen në qytete ku numri i komuniteti Egjiptian është në masë i vogël dhe nën tre sipas sistemit elektronik të organizatave, këto janë organizata të reja që iu mungon përvoja e punës me bazë në komunitet. Prandaj e nderuara zëvendëskryeministre Redjepi, i vetëdijshëm se kjo zyre udhëhiqet nga dikush tjetër dhe nuk është nën kompetenca tuaja, mirëpo pasi udhëheqni me portofolin për çështje të komuniteteve, po drejtohem për të marrë përgjigje nëse shqetësimet tona janë adresuar dhe cila është mundësia që këto çështje të rregullohen në të ardhmen. Shpresojmë që ky të jetë një lëshim teknik si lëshimi në mos figurimin e komunitetit Egjiptian në faqen zyrtare, mirëpo në këtë moment na interesojnë komunikimet e juaja dhe masat e ndërmarra për të adresuar këtë çështje. Reagimi jonë ka qenë i menjëhershëm për shqetësimet faktike mirëpo arsyetimi që kemi marrë nga kjo Zyre ka qenë jo bindës përderisa ata kishin definuar aktivitete dhe targete të organizatave përfituese për të kërkuar që të fokusohen te komuniteti Egjiptian, nuk e kishin vullnetin më të vogël për të rregulluar disa probleme teknike me disa organizata të komunitetit.



## DEPUTETI FRIDON LALA MBËSHTET LIGJIN PËR MASN E PËRKOHSHME TË ÇMIMEVE PËR PRODUKTET BAZË

Në seancen plenare të datës 20 Tetor 2022, Deputeti i IRDK-së në Parlamentin e Kosovës, Fridon lala, ka përkrah projektligjin për masat e përkohshme të produkteve themelore.

Si përfaqësues i komunitetit Egjiptian, ai ka përcjellë shqetësimet e komunitetit në raport me ngritjen enorme të çmimeve në diskutimet e mëhershme parlamentare rreth kësaj teme, duke propozuar konkretisht dhe këtë masë, vendosjen e çmimeve tavan për produktet bazë të konsumatorëve.

Ky projektligj parasheh mbrojtjen e qytetarëve nga rritja e çmimeve, duke caktuar çmimet maksimale të lejuara për produkte esenciale si drithëra, buka, orizi, miell gruri, vaji lulediellit, qumështi, shekeri, produktet e higjenës personale, lëndët e drurit për djegie etj.

Në vijim është fjalë e Deputetit Fridon Lala.

Së pari si grup parlamentar multietnik, grup që përfaqëson grupe në nevojë, që një pjesë e konsiderueshme e tyre jeton në margjina të shoqërisë kosovare, së pari e mirëpresim dhe po ashtu e mbështesim projektligjin për masat e përkohshme të produkteve themelore. Së dyti, si përfaqësues i komuniteti Egjiptian të Kosovës, njërit prej grupeve më të varfëra që jeton në vend, edhe në seancat paraprake në të cilat kemi debatuar e diskutuar rreth fenomenit të ngritjes së çmimeve të produkteve bazë dhe po ashtu rreth propozimeve të ngritjes së çmimit të energjisë elektrike, unë i kam përcjell shqetësimet serioze të komunitetit për të cilat është bërë e pa përballueshme përballja me inflacionin e lartë dhe e cila ka rezultuar me rritje enorme të çmimeve të produkteve bazë të shportës së konsumatorit. Është lehtë për ta kuptuar luftën e grupeve 90% e të cilave cilësohen si të pa punë në raportet vendore dhe ndërkombëtare. Normalisht se në kushtet normale ndërhyrja në tregun e lirë është problematike dhe jo e preferueshme, mirëpo në kriza të tillë të jashtëzakonshme dora e shtetit është e nevojshme dhe ndërhyrja me masa të ngjashme ka ndodhur edhe në vende të rajonit dhe jo vetëm. Në kushte të tillë fokus kryesor i shtetit duhet të jetë mbrojtja e interesit të qytetarëve e lufta e tyre ekzistenciale përballë një krize me përmasa globale dhe paralel me masat të cilat po prezantohen në pakot ekonomike një projektligj me masa të përkohshme për produktet esenciale është i mirëpritur nga ana e jonë.

## Me 21 Tetor 1990 themelohet Shoqata e Egjiptianëve të Kosovës

### Inicitorët e parë themelues të Shoqatës së Egjiptianëve të Kosovës

Elmi Sadriu  
Xhemajl Mustafa  
Qerim Abazi  
Tafil Rexhepi  
Nezir Kelmendi  
Bahtir Kelmendi  
Sabri Mustafa  
Rahmon Miftari  
Sokol Tafa  
Halil Halili  
Ragip Krasniqi  
Shefki Osmani  
Ali Sejdiu  
Shemsi Kopili  
Gani Ramadani  
Halit Isaku  
Vesel Kadrolli  
Ragip Berisha  
Mifail Mustafa  
Haki Mustafa

Sami Ramadani  
Elez Krasniqi  
Arif Gara  
Xhevrat Shala  
Ibish Bajrami  
Bajram Imeri  
Afrim Keraj  
Avdyl Syla  
Bajram Uka  
Hasan Kërshti  
Xhafer Murseli  
Hamdi Rushiti  
Faik Rrahmani  
Nexhmedin Xhurakovci  
Ferat Pllavci  
Ibrahim Shtitarica  
Gani Sejdiu  
Naser Bellani  
Hamit Sefedini  
Hasan Hasani

Avdi Osmani  
Shaban Rrustemaj  
Nazmi Stollaku  
Qamil Deliu  
Agim Ramadani  
Elmi Bugari  
Ramadan Rexhepi  
Fehmi Haliti  
Rrahim Abazi  
Nexhat Deliu  
Fazli Sadriu  
Gani Sadriu  
Gani Kodrolli  
Istref Shabani  
Ismet Asllani  
Salih Murtezi  
Hazis Nimani  
Enveri (nga Trepça)

### 32 VITE NGA THEMELIMI I SHOQATËS SË EGJIPTIANËVE TË KOSOVËS

Me 21 Tetor 1990, 58 intelektual e atdhetar, u mblodhën në Prishtinë për të themeluar Shoqatën e Egjiptianëve të Kosovës.

32 vite pas, i kujtojmë me krenari e i falenderojmë për guximin dhe vullnetin, 58 themeluesit e Shoqatës së parë të Egjiptianëve të Kosovës, dhe i jemi mirënjohës për kontributin e jashtëzakonshëm për kauzën tonë kombëtare.

Falë mundit, angazhimit dhe kontributit të tyre, është formësuar identiteti ynë etnik, e njëherazi është trasuar rruga, që sot ne, në liri, të mbrojmë dhe përfaqësojmë interesat e komunitetit egjiptian,



## MINISTRI ELBERT KRASNIQI VIZITON KOMUNAT NË TË CILAT PRITET REALZIMI I PROJEKTEVE

Në kuadër të bashkëfinancimit të projekteve të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal me Komunat e Kosovës, Ministri i MAPL-së ka nënshkruar marrëveshjet e bashkëpunimit me 20 komuna të Kosovës për realizimin e projekteve kapitale me fokus komunitetet. Në vlerë prej 1 milion euro.

Sipas marrëveshjeve të nënshkruara, komunat respektive do të zhvillojnë procedurat e prokurimit publik ku do të përzgjedhjen operatorët ekonomik për ekzekutimin e punimeve sipas planifikimit që kanë bërë komunat.

Për të pa progresin e implementimit të projekteve, këto ditë, ministri Elbert Krasniq është duke i vizituar komunat ku pritet të realizohen projektet. Ai bashkë me kryetarët e komunave kanë dalë në terren dhe kanë përcjellë punimet e realizuara deri me tanë. Realizimi i projekteve është i rëndësishëm përfaktin se tanë jemi duke hyrë në tremujorin e fundit të këtij viti dhe realizimi i projekteve duhet të implementohet në harmoni me dinamikën kohore deri në gjysmën e dytë të muajit dhjetor.



Me datën 04.10.2022, Ministri i MAPL Elbert Krasniqi, ka vizituar komunën e Deçanit. Me Kryetarin e Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, kanë diskutuar për priorititetet e Komunës, bashkëpunimit në mes nivelist qendror dhe atij lokal si dhe procesin e projekteve komunale të finançuara nga MAPL. Ata vizituan fillimin e punimeve për asfaltimin e rrugës "Sadrijaj" në

Gramaçel të Deçanit, të financuar nga programi për mbështetje për projektet infrastrukturore për komunitete në bashkëpunim me Komunën e Deçanit.

MAPL, do të vazhdoj të mbështhes projekte kapitale dhe infrastrukturore në Komunat e Republikës së Kosovës në mënyrë që të avancohet zhvillimi ekonomik lokal dhe të ofrohen shërbime më cilësore për qytetarët, ka theksuar ministri Elbert Krasniqi.



Me datën 05.10.2022, Ministri i MAPL, Elbert Krasniqi, ka vizituar komunën e Obiliqit. Me Kryetarin e Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashin, ata diskutuan për mbarëvajtjen e punimeve në projektet komunale të cilat janë financuar nga MAPL, rritjen e mbështetjes ndaj grupeve të marginalizuara dhe ofrimin e shërbimeve më cilësore për qytetarët.

Në Komunën e Obiliqit, në fshatin Plementin, ata vizituan dy projektet e financuara nga MAPL, projektin për rehabilitimin e

infrastrukturës fizike tek komunitetet Egjiptian, Ashkali dhe Rom të financuar nga instrumenti për investime kapitale dhe projektin punimi i kanalizimit dhe asfaltimi i rrugës në këtë fshat të financuar nga programi për projektet infrastrukturore për komunitete.



Me 29.10.2022, Ministri Elbert Krasniqi i shoqëruar nga deputeti Fridon Lala disa lagje të komunitetit egyptian në Gjakovë.

Në Dardani, Qerim, e Sefë, ata vizituan nga afër projektet infrastrukturore të finançuara nga Ministria e Pushtetit Lokal.

Në Brekoc, ata vizituan familjet e prekura nga vërshimet të cilat u përkrahen financiarisht nga Ministria e Financave.

Në Ali Ibra, njoftuan përfaqësuesit për nënshkrimin e kontratës për pastrimin e lagjes në muajin që vie, projekt i finançuar nga Ministria e Mjedisit dhe Infrastrukturës.



## DEPUTETI FRIDON LALA TAKON AKTIVISTËT DHE BASHKATDHETARËT TANË NË GJERMANI

Deputeti i IRDK-së në Parlamentin e Kosovës, Fridon Lala, prej datës 2 deri 9 tetor ka qendruar në disa qytete në Gjermani ku është takuar me udhëheqësit e strukturave të IRDK-së në Gjermani, veprimtar e bashkatdhetar që jetojnë dhe veprojnë në shtetin e Gjermanisë.



*Në Saarland, fortesën e IRDK-së në Gjermani, me përkrahës e aktivistë, për shtrirjen e strukturave në Republikën Federale Gjermane.*



Në Köln, me z. Muhamet Salihi, ish kryetar i IRDK-së në Gjermani,  
dhe aktivistët Xhemajl Mustafa dhe Muharrem Prizreni



Në Rheinen, deputeti Fridon Lala me aktivist dhe veprimtar Artan Ferizaj,  
Kenan Ferizaj, Blendi Xhepaj, Muharrem Prizreni



*Deputeti Fridon Lala me kryetarin Afrim Kryeziu*



*Në Hörste, deputeti fridon Lala ishte mysafir te shehlerët  
Muharrem e Luan Paja nga Gjakova dhe Ali Alija nga Peja.*

## VIZITË NË QUNGUR DHE TREBOVIQ

Me datën 19 Tetor 2022, Këshilltari i Ministrit të MAPL-së, Avdyl Berisha, së bashku më Zëvendës ministrin e MAPL-së, Avdo Đešević, të shoqëruar nga anëtarët e Komitetit për komunitetit në Pejë kanë vizituar lagjen Qungur dhe fshatin Treboviq të Pejës, vendbanime të banuar më komunitete.

Në këtë vizitë ata kanë biseduar më përfaqësuesit e lagjeve për problemet dhe shqetësimet e tyre, në veçanti për rregullimin e rrugës dhe kanalizimin në këto lokacione.

Këshilltari Avdyl Berisha gjithashtu ka takuar drejtorin e KEDS-it, dhe së bashku kanë shqyrtuar kërkesat e komuniteteve që janë adresuar në zyrën e IRDK-së.



## VIZITË NË KLINË, GURRAKOC DHE LUTOGLLAVË

Me datën 25 Tetor 2022, Këshilltari i Ministrit të MAPL-së, Avdyl Berisha, i shoqëruar nga këshilltari politik Muharrem Asllani, vizituam disa familje ne komunën e Klinës, lagja Mahall për t'i evituar disa probleme me shtylla elektrike. Nga komuna e Istogut në këtë vizitë i ka shoqëruar nënkyetari i komunës Valmir Rama ndërsa nga KEDS i shoqëroi drejtori për regjionin e Pejës z.Astrit Shatri.

Në të njëjtën ditë, ata kanë vizituar edhe komunën e Istogut, fshatin Gurakoc dhe në komunën e Pejës, fshatin Lutogllavë.





2022/10/

## VIZITË KOMUNITETIT EGIPTIAN NË KOMUNËN E DEÇANIT

Me datën 25 Tetor 2022, Këshilltari i Ministrit të MAPL-së, Avdyl Berisha, i shoqëruar nga Udhëheqës të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim në Deçan, Kryesuesi i Komitetit për Komunitete dhe përfaqësuesit e lagjeve, vizituam Komunën e Deçanit, vendbanimet e banuar nga komuniteti Egjiptian.

Gjatë kësaj vizite ata vizituan komunitetin Egjiptian në Pemisht të Baballoqit dhe disa lokacione të Komunës së Deçanit, më qëllim që ti identifikojmë kërkesat dhe të angazhohemi që ti adresojmë kërkesat e tyre.



# *buletini* info

Kontriboni me shkrimet e juaja autentike si:

Opinione  
Kulturë  
Histori  
Shkencë

Dërgoni në email: **buletini.info@gmail.com**